



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:094591

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644546

KPPP.nr.1779/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Banka Credins” SH.A., me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.O., avokat nga Prishtina, kundër debitorëve N.P.T.” T.P...” B.I., me numër biznesi 70078328, me seli në Suharekë fshati Mushtisht, i cili përfaqësohet nga Q.S., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.Q., avokat nga Prizreni, Q.S. me numër personal .... të cilin po ashtu sipas autorizimit e përfaqëson M.Q., avokat nga Prizreni dhe Ndërmarrja e Re “Mirusha – Banjë” SH.P.K., me numër biznesi 70459485 i përfaqësuar nga A.RR., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.244/21 të datës 06.04.2021, të Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datës 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorëve N.P.T.” T.P...” B.I., Q.S. dhe Ndërmarrja e re “Mirusha – Banjë” SH.P.K., dhe MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.244/21 i datës 06.04.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha.
- II. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t’ia paguaj kreditorit shumën prej 487€ (katërqind e tetëdhjetë e shtatë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Banka Credins” SH.A.. në ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.244/21 të datës 06.04.2021, me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor – Akt noterial “En Mynute” LRP.Nr.313/2016

dhe Ref.Nr.979/2016, i nxjerr në bazë të Kontratës së Kredisë Afatmesme Nr.5619 të datës 31.05.2016 dhe Aktvendimit mbi regjistrimin e hipotekës Nr. i Protokollit 06-375-2016, duke detyruar debitorët që në afat prej 7 ditës t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 292,851.95€ (dyqind e nëntëdhjetë e dy mijë e tetëqind e pesëdhjetë e një euro e nëntëdhjetë e pesë cent), bashkë me kamatëvonesën, përmes shitjes, zbrazjes dhe dorëzimit në posedim të paluajtshmërisë kreditorit të njësisë kadastrale P-..., zona kadastrale Banjë, në sipërfaqe prej 228,845 m<sup>2</sup>, pronë e Ndërmarrja e Re “Mirusha – Banjë”.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor debitorët N.P.T.” T.P...” dhe Q.S., kanë paraqitur prapësim, në të cilin ka kundërshtuar në tërësi lartësinë kredisë duke e cilësuar të njëjtën si shumë paushallë dhe që me asnjë provë nuk vërtetohet se kjo shumë është në përputhje me vonesën eventuale në përmbushjen e detyrimit. Kundërshton arritshmërinë e kërkesës duke cilësuar se kjo procedurë e iniciuar përmbarimore është në kundërshtim me dispozitat ligjore. Andaj i propozon gjykatës që të aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorëve dhe të shfuqizoj Urdhrin Përmbarimor P.nr.244/21 të datës 06.04.2021 si të kundërligjshëm.

Kreditori brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara dhe shtuar se nuk ekzistojnë shkaqet për prapësim nga debitori. Ka deklaruar se debitori ndonëse pretendon se shuma është paushallë dhe jo reale nuk ka paraqitur asnjë provë me të cilën vërteton përmbushjen e obligimit. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar ta lë në fuqi urdhrin përmbarimorë si të drejtë dhe të ligjshëm, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës në shumë prej 633.75€ në emër të përgatitjes së përgjigjes në prapësim në përputhje me tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata shqyrtoi këtë çështje juridike – përmbarimore në përputhje me nenin 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë*

*ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”, dhe nenit 22, par. 1.7 përcaktohet se “1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit”.*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbarues dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 të Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin përmbarues përkatësisht dokumentit përmbarimor – Akt noterial “En Mynute” LRP.Nr.313/2016 dhe Ref.Nr.979/2016, i cili është në bazë të Kontratës së Kredisë Afatmesme Nr.5619 të datës 31.05.2016.

Nga shkresat e lëndës rezulton se dokumenti përmbarimor – Akt noterial “En Mynute” LRP.Nr.313/2016 dhe Ref.Nr.979/2016, është paraqitur në kopje të noterizuar pranë zyrës noteriale në Republikën e Shqipërisë e datës 04.02.2021 Nr.Rep 1006, pranë zyrës noteriale të noterit Julian Zhelegu si dhe të njëjtës i është bashkangjitur Aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës Nr. i Protokollit 06-375-2016, i lëshuar nga Zyra Komunale e Kadastrit në Malishevë, në të cilin prona identifikohet në zonën kadastrale Banjë , P-..., në sipërfaqe prej 228,845 m<sup>2</sup>, pronë e Ndërmarrja e Re “Mirusha – Banjë”.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit në prapësim, se kredia nuk është bërë e kërkueshme, mirëpo gjykata gjeti se debitori ka rënë në vonesë pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se me datat 17.01.2020 dhe 24.01.2020 kreditori i është drejtuar debitorit me kërkesë për shlyerje të detyrimit, andaj në përputhje me nenin 305 të Ligjit Nr..04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton se: *“1. Debitori është në vonesë kur nuk e përmbush detyrimin brenda afatit të caktuar për përmbushje. 2. Në qoftë se afati për përmbushje nuk është caktuar, debitori është në vonesë kur kreditori ta ftojë që ta plotësojë detyrimin e vet, verbalisht ose me shkrim, paralajmërim jashtë gjyqësor, ose duke filluar ndonjë procedurë, qëllimi i së cilës është realizimi i përmbushjes të detyrimit.”*, gjykata vlerëson se kredia është e kërkueshme.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i’ a njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në shumën prej 487€ (katërqind e tetëdhjetë e shtatë euro) siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifat e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës në çështjet e përmbarimit në bazë të titullit përmbarimor me vlerë 100.000€ e më lartë.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje përmbare, andaj nga sa u tha më lartë vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbare si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1779/22, datë 30.04.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimt të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.